

Nr. 199 Dt. 09 03 2016
PRISHTINË-A

	KOMENTE	FO-CLRR-025
	ver. 1.0	faqe 1 nga 2

09.03.2016

Komente lidhur me: Raportin Konsultativ të ZRrE për MAR-in e KOSTT për SHTE 10

Cështjet për komentim:

Propozimet e Raportit Konsultativ

Komentimi:

Në Raportin Konsultativ për Shqyrtimin e Nëntë të Tarifave të Energjisë Elektrike, të publikuar nga ZRrE me 24 shkurt 2016, janë paraqitur propozimet për elementet e Të Hyrave Maksimale të Lejuara për KOSTT për vitin 2016.

Në vazhdim janë paraqitur komentet ndaj këtyre propozimeve për disa nga këto elemente.

1. Shpenzimet Operative

Në llogaritjet e të hyrave maksimale të KOSTT për vitin 2016 të paraqitura në Raportin Konsultativ të ZRrE-së, për Shpenzimet Operative të përfshira janë 6.39 milionë €. KOSTT beson se vlera e cila duhet të jetë e përfshirë sipas Shqyrtimit Periodik është vlera e llogaritur pas faktorit të efikasitetit prej 6,642,036 € e indeksuar me normën e inflacionit.

2. Faktori i Efikasitetit

KOSTT vazhdon të shprehë shqetësimin për normën e lartë të faktorit të efikasitetit i cili gjithashtu është aplikuar në një bazë të ulët dhe ka paraqitur problem që nga fillimi i periudhës shumëvjeçare duke e vendosur kompaninë në pozitë të vështirë duke iu referuar pamundësisë reale për arritjen e këtij caku të vendosur nga ZRrE.

3. Shpenzimet e Personelit

Në kategorinë e shpenzimeve operative është kërkuar që pozicioni i shërbimeve të personelit të rritet të paktën për pjesën e obligimit të dalë nga Kontrata Kolektive për normën e pagesës së përvojës së punës dhe kjo kërkesë është refuzuar.



Duke marrë parasysh se KOSTT është obliguar ta përmbushë këtë kërkesë dhe është duke e realizuar, kërkohet sërisht nga ZRrE që të njohë këtë shpenzim dhe si të tillë të e përfshijë në të hyrat maksimale.

4. Shpenzimet e Shërbimeve Ndihmëse

Ashtu siç është paraqitur në Raportin Konsultativ ZRrE i ka zbritur nga të hyrat maksimale 0.57 milionë € në emër të interesit për kostot e parealizuara për shërbimet ndihmëse nga viti paraprak.

Duke u bazuar në faktin se realizimi i këtyre kostove ka qenë jashtë çdo ndikimi dhe kompetence të kompanisë, si dhe duke qenë çështje e njohur politike, KOSTT kërkon që kjo zbritje në emër të interesit mos të aplikohet.

- Fundi i Dokumentit -